



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

PLANI I KONSULTIMIT

1. Emri i ligjit/politikës të propozuar: **Projektligji “Për shfuqizimin e ligjit nr.32/2018 “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”**
2. Audienca e synuar, lloji i konsultimeve (paraprake/k. për projektligjet), metodat e konsultimit, kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit

Audienca e synuar	Lloji i konsultimeve: (1) konsultime paraprake, (2) konsultime për projektligjet	Metodat e konsultimit (e-konsultimi, takimet publike,seminare,sondazhe etj.)	Kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit dhe ftesave (email, rrjetet sociale, etj.)
<i>Përfituesit e mbështetjes financiare, nëpërmjet filantropisë, për përmirësimin e infrastrukturës social-ekonomike e kulturore në Shqipëri, si dhe në diasporë.</i>	1 & 2	<i>Konsultim paraprak i Grupit të Punës</i> <i>Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik</i> <i>Konsultim ndërinstytucional</i>	<i>Postë elektronike zyrtare (Email).</i>

3. Afati kohor i aktiviteteve të konsultimit (nga fillimi deri në raportim)

Aktivitetet e parashikuara të konsultimit: 1. Takime të Grupit të Punës; 2. Konsultimi publik në RENJKP në muajin qershor 2024.

4. Burimet e nevojshme

<i>Përshkruani nr. e stafit të nevojshëm, mjetet financiare dhe teknike të nevojshme etj.</i> - Burime njerëzore të nevojshme: Grupit i Punës, që ndër të tjerë, përfshin përfaqësues nga struktura të MEPJ-së, si dhe nga institucioni i varësisë-Agjencia Kombëtare të Diasporës.

- Burime Financiare të nevojshme për plotësimin e nevojave teknike si vijojnë:

Sallë për mbajtjen e takimeve;

Ujë për pjesëmarrësit në takime;

Laptop;

Monitor, audio për takime të mundshme online.

5. Mbledhja e përgjigjeve

Përgjigjet mblidhen përmes këtyre mënyrave:

1. Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJKP);
2. Email në adresën e Koordinatorit të MEPJ për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në konsultimipublik@mfa.gov.al.